



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e VIII
Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere
Mbledhja nr. 04/21
Prishtinë, më 5.5.2021, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhjen e Komisionit morën pjesë: Armend Muja, Mërgim Lushtaku, Verica Qeraniq, Yllza Hoti, Jeta Statovci, Visar Korenica, Eman Rrahmani, Bedri Hamza, Pal Lekaj dhe Duda Balje.

Mungoi: Avdullah Hoti.

Pjesëmarrës të ftuar:

Pjesëmarrës të tjerë: Artiana Matoshi, gazetare RTK; Amire Qamili, gazetare, BIRN; Festim Bytyçi, asistent, GP- AAK; Ismail Shabani, gazetar “Kosova press”, Bjondina Çanta, zyrtare, Kuvendi i Kosovës, Doruntina Murturi, zyrtare, Kuvendi i Kosovës; Gent Bajri, xhirues; Jetmir Hoxha, kameraman, media; Gjon Musaj, kameraman, EO.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi Armend Muja, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Formimi i grupit punues për përcaktimin formatit të raportit financiar të RTK-së;**
- 3. Formimi i grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari e hapi mbledhjen dhe pyeti anëtarët, nëse kanë ndonjë propozim rreth rendit të ditës. Kryetari konstatoi se Komisioni, me gjashtë vota për, miratoi rendin e ditës.

2. Formimi i grupit punues për përcaktimin formatit të raportit financiar të RTK-së

Kryetari theksoi se sipas Rregullores së punës së Kuvendit, na lejohet për përcaktimin e grupit punues për raportin financiar të RTK-së. Formatit i raportimit do të jetë konform Ligjit të menaxhimit të financave publike. Ka pasur paqartësi lidhur me raportin e RTK-së dhe mendoj se ky grup punues do të punojë një format të qartë dhe të pranueshëm për raportim.. Ai theksoi se grupi punues ka një mandat dhe duhet të raportojë në komision, në konsultim edhe me palët tjera të interesit, përfshirë Administratën e Kuvendit. Grupi punues përbëhet prej 5 anëtarëve, ata janë:

1. Yllza Hoti,
2. Visar Korenica,
3. Verica Qeraniq,
4. Mërgim Lushtaku
5. Abdulla Hoti.

Bedri Hamza, propozoi se nëse nuk pranon z. Hoti të jetë në grupin punues, atëherë duhet të caktohet një anëtarë tjetër në vendin e tij.

Kryetari theksoi se në rast të refuzimit të z. Hoti, propozoj që në vend të tij të jetë deputetja Duda Balje. Ai, në mes tjerash, theksoi se ky grup punues duhet të përcaktojë një kryesues. E potencoi se raporti financiar i radhës i RTK-së, do të vijë në qershor. Ne duhet ta përsheptomë procesin e grupit punues, andaj mandati i këtij grupi do të jetë 30 ditë pune. Ai theksoi se grupi punues ka për detyrë t'i raportojë komisionit për punën e bërë, lidhur me raportin e RTK së.

Kryetari konstatoi se me shumicën e votave të anëtarëve të komisionit, u formua grupi punues për përcaktimin e formatit të raportit financiar të RTK-së.

3. Formimi i grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere

Kryetari theksoi se në bazë të udhëzimeve të punës, ne duhet të përcaktojmë një draft të planit të punës. Ky komision, së shpejti do ta ketë edhe agjendën legjislativë nga Qeveria. Ai tha se ne duhet të formojmë një grup punues për hartimin e draftit të parë të këtij plani. Më tej, potencoi se edhe mandati i këtij grupi punues do të jetë i limituar prej 30 ditë pune.

Grupi punues përbëhet prej 5 anëtarëve, ata janë:

1. Jeta Statovci,
2. Mërgim Lushtaku,
3. Eman Rrahmani,
4. Duda Balje ,
5. Pal Lekaj.

Kryetari konstatoi se me shumicën e votave të anëtarëve të Komisionit, u formua grupi punues për hartimin e planit vjetor të punës së Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere.

Kryetari theksoi se ky grup punues duhet të bëjë një draft pune i cili duhet të jetë i modeluar duke inkorporuar agjendën legjislativë të qeverisë dhe metodologjinë e punës së këtij komisioni, përfshirë llojet e ligjeve që duhet mbikëqyrur, seanca dëgjimore, vizita studimore etj. Po ashtu,

propozoi angazhime e konsultime të shoqërisë civile apo ekspertëve të jashtëm, aty ku konstaton se i duhet mbarëvajtjes së punës së këtij Komisioni.

Mërgim Lushtaku, theksoi se duhet të përcaktohet kryesuesi i grupit punues.

Kryetari, tha se në mbledhjen e parë që do ta bëjë grupi punues, do ta zgjedhin kryesuesin. Grupi punues për punën e tij raporton në Komision.

4. Të ndryshme

Kryetari sugjeroi që të lexohet Raportin i Progresit deri javën e ardhshme dhe t'i zgjidhni pikat që ndikojnë në ligjet bazë që i mbikëqyrë ky komision. Unë propozoj që të ketë edhe disa ndryshime në Ligjin e Bankës Qendrore, në bazë të raporteve vjetore të progresit, duke përfshirë edhe vitin 2020. Javën e ardhshme të diskutojmë çka duhet të ndërmarrë ky komision, në cilësinë e Komisionit funksional, për të kompletuar edhe rekomandimet agjendës evropiane.

Bedri Hamza, theksoi se duhet të merren për bazë të gjitha ligjet që e rregullojnë sistemin financiar, duke filluar nga Ligji për Bankën Qendrore dhe komerciale dhe ligjet tjera, duhet të ketë një koordinim dhe bashkëpunim me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Ekspertizën shumë më të thelle e më të qartë e ka Fondi Monetar Ndërkombëtarë sesa Komisioni Evropian. Për këtë duhet të jetë e involvuar edhe Banka Qendrore, të jetë në konsultim edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar. Plotësim-ndryshimi i këtyre ligjeve, pasi të vijë drafti final nga Banka Qendrore, nuk ka mundësi të bëjë sponsorizim të ligjeve. Kjo shkon ose përmes Ministrisë së Financave, ose ta marrim ne si komision, drejtpërdrejt.

Kryetari u pajtua me propozimin e z. Hamza, por theksoi se ne propozojmë që vetëm t'i lexojmë se çka u tha ne këto dy ligje, në Ligjin për bankat dhe ligjin për institucionet mikrofinanciare. Jam dakord që të diskutohet me Fondin Monetar Ndërkombëtar, po ashtu edhe me Bankën Botërore, që të japin ekspertizë, mirëpo deri në javën e ardhshme ta lexoni dhe të shikoni si duhet të jetë qasja e këtij, në raport me këto dy rekomandime.

Duda Balje, theksoi se i duhet pak ndihmë për Ministrinë për Komunitete. Si mund që ne t'i shpenzojmë mjetet që janë të ndara për komunitete, sepse me ministrinë nuk po mund të caktojmë takim. Unë dua ta di sesi kanë shkuar hollat dhe a kanë planifikua për neve diçka.

Kryetari, tha se thotë le të jetë ky si rekomandim të cilin ne e diskutojmë në mbledhjen e ardhshme mbi bazën e direktivave të këtij komisionit.

Mërgim Lushtaku, propozoi që ta shikojnë edhe raportin ballkanik e perëndimor, në rastin e Kosovës për vitin 2020, ku parashihet e analizohet pjesa ekonomike e pandemisë. Ne, si Komision për Buxhet, Punë dhe Transfere, i kryejmë punët edhe për planifikimet e ardhshme buxhetore.

Kryetari theksoi se kjo le të jetë çështje në pritje. Ai theksoi se ka disa çështje në pritje, që duhet t'i shqyrtojmë. Në pritje janë diku 20 çështje dhe shumica prej tyre janë raporte financiare të agjencive të pavarura dhe shqyrtimi i tyre kërkon më shumë kohë dhe me këtë agjendë të ngjeshur nuk mundemi t'i mbulojmë me një mbledhje në javë . Meqenëse deri më 30 korrik kemi mundësi pune, unë propozoj që të takohemi dy herë në javë.

Jeta Statovci, theksoi se në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike ishte një praktikë që kishte një deputet raportues për fusha të caktuara, deputeti e mbulonte në detaje atë fushë dhe e raportonte në komisionin. Ndoshta, si pjesë e grupit punues e Komisionit, të shpërndahej pak puna, duke e ditur që ka shumë vëllim të madh të punës në komision.

Kryetari theksoi se edhe unë pajtohem me propozimin e znj.Statovci. Kjo le të jetë si metodologji e punës, në kuadër të hartimit planit vjetor të punës, pra neve na jepet mundësia që t'i shohim edhe konkluzionet që i ka nxjerrë secili hartues.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit.

**Kryetari i Komisionit,
Armend Muja**